



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 143, datë 06.04.2021**

**PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 95 e 97/3 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. - Gjyqtarja e skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Irida Kacerja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me Kërkesues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; I pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal” (Dosje e ndarë nga të bashkëpandehurit {...}, {...}, {...}, etj., si dhe e lidhur me dosjen penale me të pandehur {...}, {...}etj., si dhe me dosjet penale me të pandehur {...}, {...}, {...}, {...}”.

**GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. - Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për caktimin e një gjyqtari, si vijon:

1. Kërkesës nr. 148 prot., datë 23.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}; Akuza: Nenet 109/b/1 dhe 28/4, 238 dhe 28/4, 152/1, 333/a/1, 334/1, 278/2 të Kodit Penal;

2. Kërkesës nr. 167 prot., datë 29.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Të pandehur: {...}e {...}; Akuza: “Neni 148 i Kodit Penal”.

3. Kërkesës nr. 176 prot., datë 02.04.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kwrkues/ tw pandehur: {...}, {...}; Objekti: “Pwrjashtimi i gjyqtareve Saida Dollani Saida Dollani dhe Nertina Kosova nga gjykimi i çështjes penale ndaj të pandehurve {...}”.

2.- Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Dritan Banushi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}{...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}{...}; Akuza: “Nenet 283/1, 28/4, 283/a/1, 283/2, 333/a/2, 334/1, 278/1, 287/1/b-25, të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**